



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 424/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, duke vendosur lidhur me ankesën subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së njoftimeve, pllakateve dhe posterëve mbi rrugë publike, në seancën e panelit të mbajtur me 13.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET si e bazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

Aleancës Kosova e Re (AKR), i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 4100 (katërmijë e njëqind) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Subjekti politik LDK, ka parashtruar ankesë më te cilën pretendon se subjekti politik AKR, ka bërë shkelje të nenit 33 pika (b) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (b), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*, në ankesë theksohet se më datë 10.12.2010 në ora 09:30 në rrugën e “UÇK” në Prishtinë, është vërejtur se subjekti politik AKR ka vendosur sloganet lidhur me fushatën zgjedhore mbi rrugën publike.

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 10.12.2010, nga subjekti politik LDK, në të cilën theksohet se subjekti politik AKR ka vendosur sloganet lidhur me fushatën zgjedhore në rrugën publike në Prishtinë që është në kundërshtim me nenin 33 pika (b) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (b), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi si dëshmi, në të cilat shihet qartë se sloganet e subjektit politik AKR, janë të vendosur në rrugën publike në Prishtinë. Parashtruesi i ankesës propozon qe të ndërmerr masat e parapara ligjore.

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i e informoi subjektin politik AKR, më datë 10.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 11.12.2010, gjerë në ora 12:00. PZAP-i, mori përgjigjeje në ankesë nga subjekti

politik AKR, jashtë afatit të caktuar, mirëpo përgjigjen në ankesë nga ky subjektit politik paneli nuk e mori në shqyrtim mbbase ka arritur pas afatit të caktuar.

Veprimet e Ndaluara të Subjekteve Politike

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (b) i LZP-së dhe nenit 3 paragrafi 1 pika (b) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalojnë nga bërja e ndonjërës si në vijim:

b) vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose hapësirave private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve.

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se sloganë i subjektit politik AKR është i vendosur në rrugën publike në rrugën "UÇK" në Prishtinë, nga kjo arsyë dhe më qëllim të evitimit të shkeljes së lartë cekur po ashtu në pajtim më dispozitat e

lart cekura ligjore PZAP-i vlerëson se ankesa është e bazuar, e lidhur me nenin 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashresa

A nr. 424/2010 më datën 13.12.2010

